

VARFËRIA NË KONSUM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË PERIUDHËN 2012 - 2015

Prill 2017

Banka Botërore
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore
Praktika Globale për Varfërinë dhe
Barazinë

www.worldbank.org

Agjencia e Statistikave të Kosovës
Departamenti i Statistikave Sociale
Sektori i Standardit Jetësor

www.ask.rks-gov.net

HYRJJE

Ky raport fokusohet në dinamikat e varfërisë absolute në Kosovë gjatë periudhës 2012-2015. Konsumi është përdorur si matës i mirëqenies apo pasurisë individuale. Konsumi i ekonomisë familjare është llogaritur si vlerë e tërësishme e shpenzimeve të ekonomisë familjare në gjëra ushqimore dhe jo-ushqimore, siç paraqitet në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), anketë përfaqësuese në nivel vendi që realizohet çdo vit, përfshirë vlerësimin e çfarëdo ushqimi të prodhuar në shtëpi dhe që është konsumuar nga ekonomia familjare. Duke iu përmbajtur praktikave të kaluara në Kosovë, shpenzimet në gjëra afatgjata dhe në qera janë të përjashtuara nga konsumi. Standardet jetësore bazuar në konsumin vlerësohen kundrejt pragut të varfërisë, që mbahet i pandryshuar në kushte reale në kohë dhe hapësirë; vlera monetare e kufirit të varfërisë azhurnohet çdo vit për të reflektuar ndryshimet në çmime.

Standardi jetësor, që lidhet me vlerën aktuale të konsumit të përgjithshëm të një ekonomie familjare, varet në masë të madhe nga madhësia dhe përbërja demografike e ekonomisë familjare. Prandaj, konsumi i ekonomisë familjare pjesëtohet me numrin e ekuivalentëve të të rriturve në familje për të llogaritur matësin e mirëqenies, që është konsumi për ekuivalentin për të rritur.

ABEF në Kosovë bazohet në një dizajn mostre dy fazëshe të stratifikuar. Korniza e mostrës bazohet në të dhënat dhe hartografinë e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 (më shumë detaje paraqiten në aneksin 1). Në vitin 2012 ka ndryshuar metodologjia e mbledhjes së të dhënave për ABEF. Derisa para vitit 2012, nga ekonomitë familjare kërkohesh të shënonin shpenzimet për gjëra ushqimore dhe shpenzimet e tjera gjatë një muaji, nga viti 2012 nga ekonomitë familjare të intervistuar u kërkua të shënonin shpenzimet për gjëra ushqimore dhe shpenzimet e tjera për dy javë. Më specifikisht, nga 8 ekonomi familjare të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme në secilin qark regjistruar, 4 ekonomi familjare marrin pjesë në anketë gjatë gjysmës së parë të muajit (periudha e parë) dhe 4 ekonomi familjare marrin pjesë gjatë gjysmës së dytë të muajit (periudha e dytë). Para vitit 2012, periudha referente për shënimin e produkteve jo ushqimore ishte një muaj, që u ndryshua në periudhë tre mujore nga viti 2012 (periudha referente për prodhimin vetanak të ushqimit ka mbetur e njëjtë, një muaj).

ME RËNDËSI: Duke pasur parasysh këto ndryshime të rëndësishme metodologjike, vlerësimet e varfërisë nga viti 2011 dhe vitet e mëhershme nuk janë të krahasueshme me vlerësimet për periudhën 2012-2015. Nuk duhet të nxirren krahasime të drejtpërdrejta të vlerësimeve të varfërisë të paraqitura në këtë raport me ato të publikimeve për vitin 2011 dhe më herët.

TRENDET E VARFËRISË SË PËRGJITHSHME GJATË PERIUDHËS 2012-2015

Në këtë raport janë përdorur dy kufij të varfërisë, një kufi i varfërisë që konsiderohet adekuat për përmbushjen e nevojave themelore dhe një kufi më i ulët i varfërisë së skajshme. Pas përshtatjes/korrigjimit për inflacionin, kufijtë e varfërisë dhe të varfërisë së skajshme janë:

- 2012: 1.79 € dhe 1.27 € për ekuivalentin për të rritur në ditë
- 2013: 1.82 € dhe 1.30 € për ekuivalentin për të rritur në ditë
- 2014: 1.83 € dhe 1.30 € për ekuivalentin për të rritur në ditë
- 2015: 1.82 € dhe 1.30 € për ekuivalentin për të rritur në ditë

Shkalla e varfërisë për kokë banori mat përqindjen e popullsisë, konsumi i ekuivalentit për të rritur i së cilës është më i ulët se kufiri i caktuar i varfërisë. Duke u bazuar në ABEF-in e vitit 2015, është vlerësuar se 17.6 përqind e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.2 përqind të popullsisë nën kufirin e varfërisë së skajshme (Figura 1). Duke krahasuar të dhënat për katër vitet, mund të vërehet se shkalla e varfërisë ka rënë për rreth 5.3 pikë të përqindjes nga viti 2012 në vitin 2013; ka shënuar rritje nga viti 2013 në vitin 2014 për 3.5 pikë të përqindjes dhe më pas është rikthyer në shkallën 17.6 të vitit 2013 – një rënie prej 3.5 pikë të përqindjes nga viti 2014. Shkallët e varfërisë në të katër vitet janë më të larta në vendbanimet rurale (Figura 1).

Figura 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas vendbanimit (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015





Figura 2: Indeksi i hendekut të varfërisë për kufirin e varfërisë dhe të varfërisë së skajshme (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015



Hendeku i varfërisë mat thellësinë e varfërisë. Ai merr parasysh edhe përqindjen e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë, por edhe madhësinë e diferencës në mes të kufirit të varfërisë dhe konsumit mesatar të atyre, që gjenden nën kufirin e varfërisë. Krahasuar me shkallën e varfërisë, përparësia e hendekut të varfërisë është se identifikon ndryshimet në mirëqenien, që ndodhin nën kufirin e varfërisë, si rastet kur ekonomitë familjare bëhen më pak të varfra, por jo aq sa të kalojnë kufirin e varfërisë. Thellësia e varfërisë ka shënuar rënie nga viti 2012 në vitin 2013, rritje në vitin 2014 dhe përsëri rënie në vitin 2015 në nivelin e shënuar në vitin 2013 (Figura 2). Trend i ngjashëm ka karakterizuar ndryshimet në thellësinë e varfërisë së skajshme. Në të katër vitet, thellësia e varfërisë është më e lartë në vendbanimet rurale. Me përjashtim të vitit 2014, ku thellësia e varfërisë është e ngjashme për vendbanimet urbane dhe rurale, thellësia e varfërisë së skajshme është më e lartë në vendbanimet rurale (Figura 2).

Tabela 1: Shpërndarja e të varfërve sipas llojit të vendbanimit (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Vendbanimi	Shpërndarja e popullsisë				Shpërndarja e të varfërve				Shpërndarja e të varfërve të skajshëm			
	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015
Urban	39.8	39.4	39.8	39.0	34.0	36.4	39.4	34.3	34.7	37.2	37.7	27.0
Rural	60.2	60.6	60.2	61.0	66.0	63.6	60.6	65.7	65.3	62.8	62.3	73.0
E përgjithshme	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Derisa rreth 60 përqind e popullsisë jeton në vendbanimet rurale në vitin 2015, rreth dy të tretat e të varfërve dhe tre të katërtat e atyre në varfëri të skajshme jetojnë në vendbanimet rurale (Tabela 1). Përqindja e të varfërve, që jetojnë në vendbanimet rurale, ka shënuar rritje për 5 pikë të përqindjes nga viti 2014 në vitin 2015 dhe për 11 pikë të përqindjes për varfërinë e skajshme.

Tabela 2: Koeficienti Gjini (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Vendbanimi	2012	2013	2014	2015
Urbane	26.2	23.5	26.0	24.4
Rurale	25.5	22.6	22.3	22.0
E përgjithshme	26.1	23.2	24.1	23.2

Koeficienti Gjini është matësi më i përdorur i pabarazisë. Koeficienti Gjini baraz me një (100%) nënkupton se i gjithë konsumi i takon një personi ndërsa duke iu afruar zeros tregon se konsumi është i shpërndarë në mënyrë të barabartë në mes të të gjithë personave, do të thotë niveli i konsumit është i barabartë për të gjithë popullsinë. Të dhënat në tabelën 2 tregojnë se pabarazia ka rënë nga viti 2012 në vitin 2013, ka shënuar rritje nga viti 2013 në 2014 dhe më pas rënie në vitin 2015. Gjatë periudhës katër vjeçare, pabarazia në vendbanimet urbane ka mbetur më e lartë se në vendbanimet rurale

Tabela 3: Shkalla e varferise sipas madhësisë së ekonomisë familjare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Madhësia e ekonomisë familjare	2012	2013	2014	2015
1	14.2	7.0	10.3	7.8
2	13.3	7.9	9.6	8.1
3	7.5	9.9	9.0	6.7
4	16.0	15.4	15.4	12.1
5	21.7	18.1	18.1	20.6
6	21.3	17.3	21.8	19.9
7 ose më shumë	27.7	19.8	25.8	19.5
E përgjithshme	22.9	17.6	21.1	17.6

Ekonomitë familjare me më shumë anëtarë kanë tendencë të jenë më të varfra, shkalla më e lartë e varfërisë është gjetur në mesin e ekonomive familjare me shtatë e më shumë anëtarë ndërsa më e ulta në mesin e ekonomive familjare me tre anëtarë (Tabela 3). Në vitin 2015, rreth 23 përqind e ekonomive familjare të madhësisë mesatare (5 anëtarëshe) në Kosovë janë të varfra

Tabela 4: Incidenca e varfërisë dhe shpërndarja e varfërisë sipas madhësisë së ekonomive familjare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Madhësia e ekonomisë familjare	Shpërndarja e të së varfërve (%)				Shpërndarja e popullsisë (%)			
	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015
1	0.3	0.3	0.3	0.3	0.5	0.7	0.6	0.8
2	1.4	1.2	1.3	1.6	2.5	2.8	2.9	3.4
3	1.6	2.7	1.9	2.1	4.8	4.8	4.5	5.5
4	7.8	10.4	8.0	9.5	11.2	11.8	11.0	13.7
5	16.3	18.9	16.8	22.6	17.2	18.3	19.6	19.3
6	16.8	19.4	18.7	20.5	18.0	19.8	18.1	18.1
7+	55.8	47.1	53.0	43.4	46.0	41.8	43.3	39.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Siç vërehet në tabelën 4, në vitin 2015 një përqindje e madhe e të varfërve jetojnë në ekonomitë familjare me shtatë e më shumë anëtarë (43.4%), shifër kjo më e ulët krahasuar me tre vitet paraprake (2012-2014).

Tabela 5: Shkalla e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve sipas burimit kryesor të të ardhurave të ekonomisë familjare (%) 2012 - 2015

Burimi: ABEF 2012-2015


Burimi kryesor i të ardhurave	Shkalla e varfërisë				Shpërndarja e të varfërve				Shpërndarja e popullsisë			
	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015
Rrogat dhe pagesat nga sektori publik	14.1	8.07	12.9	7.4	14.0	10.8	13.4	11.3	22.7	23.5	22.0	26.8
Rrogat dhe pagesat nga sektori privat	19.1	17.5	18.7	18.1	19.8	30.4	28.7	25.2	23.7	30.5	32.5	24.6
Bujqësia	37.9	10.8	22.9	13.2	10.0	3.9	4.9	4.5	6.0	6.4	4.5	6.0
Puna me medijtje	31.3	31.9	33.6	33.8	13.9	14.4	13.6	14.2	10.2	8.0	7.8	7.4
Biznese të tjera të ekonomisë familjare	13.4	12.3	10.2	11.7	10.0	8.4	5.7	8.8	17.0	12.0	11.9	13.2
Pensionet	31.8	21.7	24.0	27.8	7.6	8.7	10.1	13.7	5.5	7.1	8.9	8.7
Remitencat nga jashtë	17.8	13.6	17.4	10.1	6.6	4.9	5.3	3.9	8.4	6.4	6.4	6.8
Ndihmat sociale – Kategoria e pare	77.2	60.4	76.6	70.7	13.1	12.4	11.2	13.2	3.9	3.6	3.1	3.3
E përgjithshme	22.9	17.6	21.1	17.6	100	100	100	100	100	100	100	100

Shënim: Kategoritë në vijim nuk raportohen për shkak të numrit të vogël të rasteve (më pak se 2 përqind e popullsisë) – remitencat e tjera, ndihmat sociale - kategoria e dytë, të ardhurat nga prona, dhe të tjera. Kategoria 'të ardhurat nga prona' është përfshirë për herë të parë në pyetësinorin e ABEF në vitin 2015

Në vitin 2015, shkalla më e ulët e varfërisë është në mesin e ekonomive familjare, që në radhë të parë varen nga punësimi me rrogë në sektorin publik, remitencat nga jashtë, biznese private të ekonomisë familjare dhe bujqësia (Tabela 5). Në vitin 2015, shkalla e varfërisë është më e larta në mesin e ekonomive familjare, që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmat sociale, dhe përbëjnë rreth një të pestat e të varfërve. Duke krahasuar të dhënat e vitit 2014 dhe 2015 (Tabela 5), shkalla e varfërisë është rritur për ekonomitë familjare, që burim kryesor të të ardhurave kanë pensionet, kurse gjendje më e mirë është hasur tek ekonomitë familjare që varen nga rrogat në sektorin publik, bujqësia dhe remitencat nga jashtë. Sa i përket shpërndarjes së të varfërve në dy vitet, afër 40 përqind e të varfërve jetojnë në ekonomitë familjare, që kryesisht varen nga rrogat nga sektori publik dhe privat.

Figura 3: Varfëria sipas gjinisë së kryefamiljarit (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015



Shkalla e varfërisë është pak më e lartë në mesin e ekonomive familjare, ku kryefamiljari është i gjinisë femërore (Figura 3). Nga viti 2012 në 2013, shkalla e varfërisë tek ekonomitë familjare me kryefamiljarin femër ka rënë për rreth 8 pikë përqindjeje, pastaj është rritur në vitin 2014 për rreth po aq pikë përqindjeje, dhe më pas ka rënë për 2.3 pikë përqindjeje në vitin 2015. Këto ndryshime të mëdha në shkallët e varfërisë tek familjet me kryefamiljarin femër duhet të trajtohen me kujdes për shkak të mostrës së vogël të ekonomive familjare me kryefamiljarin femër, vetëm rreth 300 ekonomi familjare në vit

Figura 4: Varfëria sipas gjinisë së individëve (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015




Figura 4 paraqet lidhjen në mes të varfërisë dhe gjinisë së individëve. Në vitin 2015, 18 përqind e femrave në Kosovë jetojnë në varfëri në krahasim me 17.2 përqind të meshkujve, pothuajse një pike përqindjeje diferencë. Nga viti 2012 në 2015, shkalla e varfërisë ka rënë ndjeshëm më shumë për meshkujt se për femrat (5.1 dhe 5.5 pikë përqindjeje).

Tabela 6: Shkalla e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve në bazë të nivelit më të lartë arsimor të përfunduar (15 vjeç e më shumë) (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Niveli arsimor	Shkalla e varfërisë (%)				Shpërndarja e të varfërve (%)				Shpërndarja e popullsisë (%)			
	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015
Më pak se shkollën fillore të plotë	36.7	20.6	29.7	22.9	18.2	12.6	17.1	14.3	10.8	10.2	11.1	10.3
Shkollën fillore	24.5	19.9	21.7	18.8	45.8	46.8	41.7	40.7	40.9	39.3	37.2	35.8
Shkollën e mesme ose profesionale	18.2	15.5	17.0	15.7	33.3	37.2	36.6	41.0	40.0	40.3	41.6	43.2
Nivelin terciar	7.2	5.6	8.7	6.2	2.7	3.4	4.6	4.0	8.3	10.2	10.2	10.7

Në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 2012 deri 2015, individët me nivel më të ulët shkollimi kanë më shumë gjasa të jenë të varfër në krahasim me ata me nivel më të lartë shkollimi (Tabela 6). Shkalla e varfërisë tek individët, që nuk e kanë të përfunduar shkollën fillore është 22.9 në krahasim me 6.2 përqind për ata që e kanë përfunduar universitetin (nivelin terciar). Në vitin 2015, më shumë se gjysma e individëve të moshës 15 vjeç e më shumë, që nuk kanë përfunduar as shkollën fillore, jetojnë në ekonomi familjare të varfra në krahasim me 4.0 përqind të individëve me diplomë universitare. Rreth 40 përqind e të varfërve kanë më pak se shkollën e mesme të përfunduar

Tabela 7 paraqet informatat në nivel të individëve duke analizuar lidhjen midis varfërisë dhe aktivitetit kryesor të individit, për personat e moshës 15 vjeç e më shumë. Sa i përket përbërjes së popullsisë së varfër, mund të vërehet se afër një e treta e të varfërve të rritur janë me aftësi të kufizuar dhe rreth 30 përqind janë nxënës/studentë. Shkalla e varfërisë duket të jetë më e ulta në mesin e të punësuarve me orar të plotë, si dhe tek personat e vetëpunësuar dhe bujqit, kurse më e larta tek të punësuarit në punë të rastësishme dhe tek personat me aftësi të kufizuar.

Tabela 7: Incidenca e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve sipas aktivitetit kryesor të individëve (15 vjeç e më shumë) (%), 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Aktiviteti kryesor	Shkalla e varfërisë				Shpërndarja e të varfërve				Shpërndarja e popullsisë			
	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015	2012	2013	2014	2015
I punësuar, me orar të plotë	12.0	9.2	12.0	9.3	8.8	8.5	9.2	8.3	16.1	15.9	15.4	15.3
I punësuar në punë të rastësishme	32.8	29.0	29.6	26.0	6.5	5.8	4.8	4.1	4.3	3.4	3.2	2.7
Bujk	33.5	12.0	16.7	7.0	5.1	2.0	1.8	1.0	3.3	2.9	2.1	2.5
Të vetëpunësuar të tjerë	11.3	11.0	8.1	10.4	2.2	2.1	1.4	2.3	4.3	3.3	3.4	3.7
Nxënës/ Student	22.9	18.8	20.3	18.2	16.8	30.6	27.3	28.1	17.0	28.1	26.9	26.4
Pensionuar	22.2	11.6	14.6	14.0	11.2	6.8	7.4	8.7	11.0	10.1	10.2	10.6
Me aftësi të kufizuar	26.3	24.2	27.1	23.5	27.1	27.7	31.6	32.4	22.6	19.7	23.3	23.5
Papunësuar	22.1	16.9	19.9	16.7	17.5	14.1	12.5	12.0	17.4	14.3	12.5	12.3
E përgjithshme	22.9	17.6	21.1	17.6	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Figura 5: Shkalla e varfërisë sipas vendbanimit për popullsinë e përgjithshme dhe fëmijët e moshës 0-18 vjeçare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015




Figura 5 paraqet të dhënat mbi varfërinë për fëmijët. Për këtë analizë fëmijë definohet çdo person deri në, duke përfshirë, moshën 18 vjeçare. Fëmijët kanë më shumë gjasë se të tjerët të jenë të varfër. Shkalla e varfërisë të fëmijët në vitin 2015 ishte 20.7 përqind në krahasim me 17.6 përqind për popullsinë e përgjithshme. Shkalla e varfërisë për fëmijët ka rënë për 5.5 pikë të përqindjes nga viti 2012 në 2015, kurse për popullsinë e përgjithshme ka rënë për shkallë pak më të ulët (5.3 pikë të përqindjes).

Figura 6: Shkalla e varfërisë së skajshme sipas vendbanimit për popullsinë e përgjithshme dhe fëmijët e moshës 0-18 vjeçare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015




Figura 6 paraqet të dhënat mbi varfërinë e skajshme për fëmijët. Fëmijët kanë më shumë gjasa se të tjerët të jenë në varfëri të skajshme. Shkalla e varfërisë së fëmijëve në vitin 2015 ishte 6.6 në krahasim me 5.2 sa është për popullsinë e përgjithshme. Krahasuar me vitin 2012, shkalla e varfërisë së skajshme të fëmijët në vitin 2012 ishte më e ulët për 3.4 pikë të përqindjes.

Tabelat 8 dhe 9 paraqesin të dhënat mbi varfërinë e përgjithshme dhe varfërinë e skajshme për lloje të ndryshme të ekonomive familjare. Në përgjithësi, ekonomitë familjare pa fëmijë kanë shkallë më të ulët varfërie se ato me fëmijë, dhe shkalla e varfërisë rritet me rritjen e numrit të fëmijëve në ekonominë familjare.

Tabla 8: Shkalla e varfërisë sipas llojit të ekonomive familjare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Lloji i ekonomisë familjare	2012	2013	2014	2015
Pa fëmijë	15.9	13.0	13.3	13.4
Me një fëmijë	22.6	16.1	19.4	16.8
Me dy fëmijë	27.8	20.0	21.3	18.3
Me 3 ose më shumë fëmijë	25.2	20.8	29.4	22.2
E përgjithshme	22.9	17.6	21.1	17.6

Tabla 9: Shkalla e varfërisë së skajshme sipas llojit të ekonomive familjare (%) 2012-2015

Burimi: ABEF 2012-2015

Lloji i ekonomisë familjare	2012	2013	2014	2015
Pa fëmijë	4.6	4.1	3.7	4.2
Me një fëmijë	6.5	5.0	5.9	3.7
Me dy fëmijë	10.3	5.6	7.4	4.3
Me 3 ose më shumë fëmijë	10.1	8.0	10.2	8.0
E përgjithshme	8.1	5.8	6.9	5.2

ANEKSI MBI METODOLOGJINË: DIZAJNI I MOSTRËS DHE LLOGARITJA E PESHAVE

Përmbledhje e dizajnit të mostrës për ABEF 2012-2015

Kosova është ndarë në qarqe regjistruese (QR), që janë segmente relativisht të vogla operationale, të përcaktuara për qëllim të regjistrimit të popullsisë. Janë definuar gjithsej 4,626 QR në Kosovë dhe këto janë përdorur si njësi primare të mostrimit, të përzgjedhura në fazën e parë të nxjerrjes së mostrës për ABEF. Numri i përgjithshëm mesatar i ekonomive familjare për QR në kornizën e mostrës ishte 67; madhësia mesatare e QR-ve urbane (103 ekonomi familjare) ishte pothuajse sa dy herë e madhësisë së QR-ve rurale (53 ekonomi familjare). Gjatë regjistrimit, një intervistues ishte përgjegjës për regjistrimin e ekonomive familjare dhe popullsisë në një QR. ASK-ja ka përdorur të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 për të krijuar kornizën e mostrës të QR-ve, që është përdorur për përzgjedhjen e mostrës së ABEF-it. Kosova ndahet gjeografikisht në shtatë rajone. ASK-ja përdor këto shtatë rajone për stratifikimin e kornizës së mostrës dhe për raportimin e rezultateve nga anketat me ekonomitë familjare. Çdo rajon ndahet në komuna, që më pas ndahen në qytete ose lokalitete. QR-të janë definuar brenda njësive më të vogla administrative. Çdo QR është klasifikuar si urbane ose rurale, dhe ky klasifikim përdoret për definimin e shtresës së mostrës në secilin rajon.

Në kohën e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011, ASK-ja nuk kishte mundësi të realizonte regjistrimin në tri komunat në veri (Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) si dhe në një pjesë të komunës së Mitrovicës, me përqendrim të lartë të popullsisë serbe. Për këtë arsye, rezultatet përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 në Kosovë përjashtojnë ekonomitë familjare dhe popullsinë në ato zona. Megjithatë, ASK-ja kishte definuar më parë QR-të për ato zona dhe të njejtat ishin listuar në vitin 2008 (në formë të një mostre master prej 1,000 QR-ve për anketat me ekonomi familjare) ose në vitin 2009 (për QR-të e mbetura). Prandaj, ASK-ja ka përdorur këtë informacion të mëparshëm për QR-të e përjashtuara në regjistrimin e vitit 2011, për të plotësuar kornizën për pjesën tjetër të Kosovës me informatat nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. 257 QR në komunat veriore janë në kornizë me informacionin nga listimi i 2008/09. Këto QR janë të integruara me QR-të e pjesës tjetër të Kosovës me informatat nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2011, duke përbërë gjithsej 4,626 QR në kornizën e kombinuar.

Njësitë primare të mostrimit për ABEF janë marrë nga mostra e AFP-së. Në fazën e parë është përzgjedhur mostra prej 300 QR-ve me probabilitet proporcional me madhësinë në secilën shtresë (rajon, urban/rural), kurse në fazën e dytë është përzgjedhur mostra prej 12 ekonomish familjare në secilën QR në mostër, që do të thotë se janë 8 ekonomi familjare të rregullta dhe 4 që shërbejnë si rezervë.

Metodologjia e përgjithshme e kalkulimit të peshave

INë mënyrë që vlerësimet nga mostra e ABEF-it të jenë përfaqësuese të popullsisë, duhet të aplikohen peshat e mostrimit. Pesha themelore për çdo ekonomi familjare në mostër është e barabartë me inversin e probabilitetit të përzgjedhjes së saj (llogaritet duke shumëzuar probabilitetet në secilën fazë të mostrimit). Probabilitetet e përzgjedhjes bazohen në një dizajn mostre dy-fazëshe të stratifikuar. Në fazën e parë është përzgjedhur një mostër e QR-ve me probabilitet proporcional me madhësinë brenda çdo shtrese (rajon, urban / rural), dhe në fazën e dytë një mostër prej 8 ekonomish familjare në çdo QR të mostrës. Duke u bazuar në këtë dizajn mostre, probabilitetet e përzgjedhjes për ekonomitë familjare në çdo QR në mostër mund të paraqiten si mëposhtë:

$$p_{hi} = \frac{n_h \times M_{hi}}{M_h} \times \frac{m_{ni}}{M_{ni}}$$

nh = numri i QR-ve mostër të përzgjedhur në shtresën h për ABEF

Mhi = numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në kornizën e mostrës për QR-në e i-të mostër në shtresën h

Mh = numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në kornizën e mostrës për shtresën h (që është masa e kumuluar e madhësisë për shtresën)

mhi = numri i ekonomive familjare mostër të përzgjedhura në QR e i-të mostër në shtresën h

Pesha themelore e mostrës llogaritet si inversi i këtij probabiliteti të përzgjedhjes. Bazuar në shprehjen e mëparshme për probabilitetin, pesha mund të llogaritet si vijon:

$$W_{hi} = \frac{M_h}{n_h \times M_{hi}}$$

ku:

W_{hi} = pesha themelore e ekonomive familjare mostër në QR e i-të mostër në shtresën h

Është e rëndësishme të përshtaten peshat themelore për ekonomitë familjare në mostër për të marrë parasysh mospërgjigjen e ekonomive familjare në secilën QR mostër. Pasi peshat llogariten në nivel të QR-së mostër, është e dobishme që peshat të përshtaten në këtë nivel. Pesha përfundimtare (W'hi) për ekonomitë familjare mostër në QR-në e i-të mostër në shtresën h, mund të shprehet si mëposhtë:

$$W'_{hi} = W_{hi} \times \frac{n_h}{n'_h}$$

ku:

n_h = numri i QR-ve mostër me intervista të përfunduara në shtresën h për ABEF.

Që nga viti 2013 deri në 2015, peshat përfundimtare janë llogaritur duke përdorur faktorin e përshtatjes.

Për ABEF-in e vitit 2015, peshat janë llogaritur si mëposhtë:

$$AHBS = \frac{H_{2014}}{H_{2015}}$$

ku:

H_{2014} = numri i përgjithshëm i ekonomive familjare për Kosovë nga viti i kaluar (2014)

$\hat{H}_{2015} = \sum_h \sum_i W_{hi}^i = x n_{hi}$ vlerësimet e peshuara të ekonomive familjare të Kosovës nga të

$x n_{hi}$ = numri i ekonomive familjare në QR-në e i-të mostër në shtresën h në të dhënat e ABEF 2015.

Peshat përfundimtare të ABEF 2015 janë llogaritur duke shumëzuar peshat themelore, të përshtatura për mospërgjigjen, me këtë faktor përshtatjeje për ekonomitë familjare, si në vijim:

$$W_{hi}^a = W_{hi}^i \times A_{HBS}$$

ku:

W_{hi}^a = pesha përfundimtare e peshuar për ekonomitë familjare mostër në QR-në e i-të mostër në shtresën h.

Për më shumë informacione, ju lutem kontaktoni:

T: +381 38 200 31 141

E: infoask@rks-gov.net

Publikues:

Agjencia e Statistikave të Kosovës
Rr. Zenel Salihu, Nr.4 Prishtinë, Kosovë

Kur përdorni këto të dhëna, ju lutemi theksoni burimin!



VARFËRIA NË KONSUM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË PERIUDHËN 2012 - 2015

Prill 2017